



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
SHKODËR

Nr. 1197/1 Prot.

Shkodër, më datë 01.07.2024

VENDIM

Nr. 15, datë 01.07.2024

Këshilli i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër i përbërë nga:

Z. Sokol Shehu	- Kryetar
Z. Tonin Sterkaj	- Anëtar
Znj.Valbona Sulejmani	- Anëtare

Sot më datë 01.07.2024, me sekretare Anita Sinani, këshilli i kësaj gjykate u mbledh me rend dite ndër të tjera:

- Anullimin e pjesshëm të vendimit nr. 14 datë 25.06.2024 të Këshillit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër “Për shpallje konkurimi për vende të lira pune nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, dhe pranimin në shërbimin civile në kategorinë ekzekutive”, për pozicionin: Specialist i Burimeve Njerëzore dhe Specialist i Prokurimit Publik, vetëm sa i përket pozicionit të Specialist i Burimeve Njerëzore.

Sa më sipër ky këshill vëren se:

Me datës 25.06.2024, me vendimin nr. 14, ky këshill ka disponuar në përputhje me përcaktimet e Ligjit “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” dhe vendimit nr. 622, datë 10.12.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor”, për shpalljen e procedurave për lëvizjen paralele dhe pranimin në shërbimin civil për dy pozicione, atë të specialistit burimeve njerëzore dhe specialistit të prokurimeve.

Në bazë të këtij vendimi janë përpiluar edhe shpalljet për këto pozicione pune, konkretisht: Shpallje nr. 1204 prot, datë 25.06.2024 “Për lëvizjen paralele dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor në kategorinë ekzekutive “Specialist i Prokurimit Publik”; Shpallje nr. 1205 prot, datë 25.06.2024 “Për lëvizjen paralele dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor në kategorinë ekzekutive “Specialist i Burimeve Njerëzore“;

Këto shpallje janë përgatitur dhe shpallur në faqen zyrtare nën kujdesin e kancelarit, njëkohësisht anëtar i këtij këshilli dhe nënshkruar nga të gjithë anëtarët e tjerë.

Nga verifikimi i rastësishëm në faqen zyrtare të këtyre shpalljeve rezultoi se për shkak të një gabimi material në përmbajtjen e tyre, ato referojnë kërkesa për të kandidatët e mundshëm për aplikim, jo në përputhje me aneksin e detajimit të detyrave sipas vendimit nr. 150 datë 29.03.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, konkretisht si vijon:

Shpallje Nr. 1205 prot, datë 25.06.2024 për pozicionin e “Specialistit të Burimeve Njerëzore” referon tek kriteret e veçanta, që aplikuesi/kandidati duhet të jetë i diplomuar me diplomë të nivelit *master shkencor*, ndërkohë që kriteri i përcaktuar me vendimin nr. 150 është që të jetë i diplomuar *të paktën në nivelin Bachelor*. Gjithashtu edhe përvoja profesionale e kërkuar në shpallje si “*një vit punë*” nuk është në përputhje me kriterin e përcaktuar në vendimin nr. 150 “*një vit praktikë profesionale*”.

Në lidhje me detyrat e përshkruara në këtë shpallje, ato nuk janë në përputhje me vendimin nr. 150, datë 29.03.2023 të KLGJ-së, pasi këtij pozicioni i referohen detyra që nuk kanë lidhje me ‘të dhe nuk përcaktohen në asnjë paketë ligjore apo rregullore të gjykatës.

Sa më sipër, ky këshill konstaton se kriteret e veçanta dhe detyrat e përshkruara në shpalljen nr. 1205 prot., datë 25.06.2024 çenojnë të drejtën e një kategorie jo të vogël të mundshme kandidatësh për të aplikuar në këtë pozicion pune. Në këto kushte, për shkak të datës së konstatimit të këtyre të metave në shpallje dhe ecjes së afateve të përshkruara në shpallje, ky këshill vlerëson se kjo procedurë duhet anuluar, duke rifilluar atë në një moment të dytë, pas përfundimit të lejes vjetore të muajit gusht të gjykatës.

VENDOSI:

1. Anullimin e pjesshëm të vendimit nr. 14, datë 25.06.2024, nr. 1197 prot., datë 25.06.2024, “Për shpallje konkurimi për vende të lira pune nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive”, vetëm pjesa i përket 1 (një) vendi vakante, në pozicionin “**Specialist i Burimeve Njerëzore**”, të Këshillit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër.
2. Anullimin e shpalljes nr. 1205 prot, datë 25.06.2024 “Për shpallje për lëvizje paralele dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive” për pozicionin për 1 (një) vend vakant, në pozicionin “**Specialist i Burimeve Njerëzore**”, të Këshillit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të gjykatës, si dhe i komunikohet KLGJ-së dhe çdo gjykatë.

ANËTAR

Tonin STERKAJ

ANËTARE

Valbona SULEJMANI

KRYETAR

Sokol SHEHU

